

LIGJ
Nr.7675, datë 2.3.1993

**PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR
TARIFAT DOGANORE"**

Në mbështetje të nenit nr.16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 9 ndryshon si vijon:

"Taksat e eksportit për mallrat sipas listës nr.3 bashkëngjitur, shprehen në përqindje ndaj vlerës së mallrave të eksportuara.

Taksat konkrete për çdo artikull vendosen dhe ndryshohen brenda kufijve të lartpërmendur vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Në nenin 19, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i lihet deri në 2 për qind e të ardhurave doganore vjetore për t'i përdorur për investime, për përmirësimin e mjediseve të punës dhe për shpërblimin e punonjësve; shpërblimi të jetë deri në 10 paga mujore në vit.

Masa deri në 2 për qind caktohet nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë."

Neni 3

Neni 20 ndryshohet si vijon:

Përjashtimet nga taksat doganore

Përjashtimet nga taksat doganore jepen në këto raste:

a) Për mjetet e huaja të transportit që bëjnë transportin ndërkombëtar të mallrave, pasagjerëve e bagazheve, si dhe për pajisjet karburantet, furnizimet e bordit, të nevojshme për funksionimin normal të tyre.

b) Për të garantuar veprimtarinë prodhuese të anijeve shqiptare dhe atyre që merren me qira nga kompanitë ose agjencitë shqiptare, për pajisjet dhe makineritë teknike, lëndët djegëse, lëndët e para të përdorura në proceset e tyre industriale, furnizimet e bordit të eksportuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe për rezultatet e peshkimit të tyre të importuara në Republikën e Shqipërisë.

c) Për valutën dhe letrat me vlerë, shqiptare dhe të huaja.

ç) Për mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me marrëveshjet qeveritare dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, këto të fundit të miratuara nga Republika e Shqipërisë.

d) Për mallrat e importuara në Shqipëri për shoqatat, organizatat dhe institucionet në formën e ndihmave humanitare falas.

dh) Për mallrat e eksportuara dhe të riimportuara në të njëjtën gjendje në Shqipëri, pa ndryshuar nacionalitetin shqiptar.

e) Për mallrat e importuara, të vendosura nën një regjim të ndërmjetëm doganor dhe të rieksporuara nga Shqipëria.

ë) Për mallrat e huaja të riimportuara në Republikën e Shqipërisë, për të cilat janë paguar taksat gjatë importimit të tyre të parë.

f) Për mallrat në pronësi të shtetit, që kanë qenë në përdorim jashtë dhe importohen në Shqipëri.

g) Për makineritë e pajisjet e importuara në formën e investimeve nga personat juridikë vendas a të huaj, si dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre, të cilat përcaktohen me akte nënligjore nga Këshilli i Ministrave.

gj) Për mallrat e konsumit ushqimor bazë, sipas listës nr.1 të bashkëngjitur.

h) Për medikamentet, pajisjet, aparaturat dhe materialet e konsumit mjekësor.

i) Për mallrat e importuara dhe të reklamuar nga blerësi në momentin e zhdoganimit.

Neni 4

Në emërtesën e mallrave niveli i taksave doganore ndryshon sipas listës nr.2 të bashkëngjitur.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.480, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Lista nr.1

LISTA E MALLRAVE TË KONSUMIT USHQIMOR BAZË QË PËRJASHTOHEN NGA TAKSAT DOGANORE

Numri i kreut	Emërtimi i mallit
02.00	Mishi
04.00	Vezë
04.00	Nënproduktet e qumështit
10.00	Orizi
11.00	Miell
15.00	Vaj ushqimor
17.00	Sheqer
19.00	Makarona
34.00	Sapun rrobash

Lista nr.2

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E ANEKSIT TË LIGJIT TË TARIFAVE DOGANORE

Nr.	P e r s h k r i m i	Tarifa doganore në %
a	b	c
01.00	Kafshët e gjalla	10
02.00	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme	10
03.00	Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe jovertebrorët etj.	10
04.00	Produktet bulmetore, vezët e shpendëve, mjalhtë natyral, produkte me origjinë kafshore të paspecifikuara diku tjetër	10
05.00	Produktet me origjinë kafshore të papërfshira diku tjetër	10
06.00	Pemët dhe bimët e tjera të gjalla, lulët dhe gjethnajat zbukuruese	10
07.00	Zarzatet e ngrënshme dhe rrënjët e tyre si dhe filizat	10
08.00	Frutat dhe arrat e ngrënshme, lëkurët e agrumeve dhe të pjeprave	10
09.00	Kafe, çaj, mate dhe beharna	15
10.00	Drithra	5
11.00	Produktet e industrisë bluajtëse, maja, nisheste etj.	10
12.00	Farërat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore, bimët industriale dhe medicinale, kashta dhe tagjia	5
13.00	Gomë, rëshirë, ngjitës, lëngje dhe ekstrakte të tjera	20
14.00	Materiale me origjinë bimë që përdoren për thurje, produktet e paspecifikuara diku tjetër	10
15.00	Yndyrnat shtazore apo vegjetale	10
16.00	Ushqimet e përgatitura prej mishit apo peshkut, molusqeve e kafshëve të tjera të nënujshme	15
17.00	Sheqeri dhe ëmbëlsirat	15
18.00	Kakao dhe produktet e tij	15
19.00	Ushqimet e përgatitura prej drithrave, produkteve e pasticerisë apo brumit	15
20.00	Ushqimet e përgatitura prej zarzavateve, frutave, arave dhe pjesëve të tjera të bimëve	15
21.00	Përgatitjet e ndryshme të ngrënshme	15
22.00	Pijet, alkoolët dhe uthullat	20
23.00	Mbetjet dhe mbeturinat e industrisë ushqimore, tagjia e përgatitur për kafshët	10
24.00	Duhani dhe zëvendësuesit e prodhuar prej tij	20
25.00	Kripërat, sulfuret, oksidet dhe gurët, materialet suvatuese, gëlqere, çimento	10
26.00	Xehorët, hiri dhe zgjyrat	10
27.00	Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze, dyllet minerale	10
28.00	Kimikatet inorganike	10
29.00	Kimikatet organike	10
30.00	Produktet farmaceutike	0
31.00	Plehërat kimike	30

32.00	Ekstratet ngjyrosëse, bojrat stuko dhe mastiçet, bojrat e shkrimit	20
33.00	Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, preparatet kozmetike të parfumerisë dhe tualetit	40
34.00	Sapuni, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, preparatet pastrues apo lustrues dentare me bazë allçiu	15
35.00	Substancat albuminoidale, produktet me bazë amidoni, ose nisheste, tutkallet dhe enizmat	20
36.00	Eksplozivet, shkrepset, përgatitjet e caktuara të djegshme	20
37.00	Mallrat fotografike dhe kinematografike	15
38.00	Produkte të ndryshme kimike	20
39.00	Plastika dhe artikujt e tyre	20
40.00	Gomat dhe artikujt e tyre	20
41.00	Lëkurët (si lëndë e parë përveç gëzofit) dhe lëkurët e përpunuara	10
42.00	Artikujt prej lëkure	40
43.00	Gëzofët dhe qimet artificiale, prodhimet e tyre	40
44.00	Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit	30
45.00	Tapat dhe artikujt prej tape	10
46.00	Prodhimet e kashtës, prodhimi i shportave dhe punëve të tjera prej xunkthi	40
47.00	Brumi i drurit, materialet fibroze, celulozike. Mbeturinat e letrës dhe kartonit	10
48.00	Letra dhe kartoni, artikujt e brumit të letrës apo të kartonit	10
49.00	Librat, revistat, fotografitë dhe produkte të industrisë së shtypit, dorëshkrimet dhe projektet	10
50.00	Mëndafshi	10
51.00	Leshi, qimet e kafshëve, fijet e flokëve të kalit dhe pëlhurat e thurura	5
52.00	Pambuku	5
53.00	Fibrat tekstile me origjinë vegjetale, fijet prej letre dhe pëlhure të thurura prej tyre	5
54.00	Filamentet e bëra nga njerëzit	10
55.00	Fibrat kryesore të bëra nga njerëzit	10
56.00	Vatina, leshi i presuar dhe pëlhura të tjera të pathurura, fijet speciale, litarët, spangot, artikujt e tyre	10
57.00	Qylymat dhe mbuluesit e tjerë të dyshemesë	40
58.00	Pëlhurat speciale të thurura, pëlhura tekstile me push, tantellat, tapiceritë, zbukurimet dhe qendismat	40
59.00	Pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura apo të mbuluara, artikuj tekstile për përdorim industrial	30
60.00	Pëlhurat e thurura apo krosheetet	20
61.00	Artikujt e veshjes dhe rroba të tjera të thurura apo kroshe	30
62.00	Artikujt e veshjes dhe rroba të tjera jo të thurura	30
63.00	Artikuj të tjerë tekstile, rrobat e përdorura, lecka mbeturina	20
64.00	Veshjet e këmbëve, gjynjaket dhe artikuj të tjerë të ngjashme me to	15
65.00	Veshjet e kokës dhe pjesët e tyre	40

66.00	Çadtrat, çadtrat e diellit, bastunet, kamzhikët	40
67.00	Puplat dhe pushi dhe artikujt e tjerë të bërë nga puplat, lulet artificiale, artikujt e bërë nga flokët e njerëzve	40
68.00	Artikuj prej guri, allçie, çimento, mike etj.	10
69.00	Produkte prej qeramike	10
70.00	Qelqi dhe qelqurinat	15
71.01	Perlat natyrale, apo të kultivuara, gurët e çmuar, metalet e çmuara	10
71.02	Mallra të tjera të bizhuterisë, të argjendarëve, të arpunuesve etj.	40
72.00	Giza hekuri dhe çeliku	20
73.00	Artikujt e gizës dhe të çelikut	20
74.00	Bakri dhe artikujt e tjerë	20
75.00	Nikeli dhe artikujt prej tij	10
76.00	Alumini dhe artikujt prej tij	10
77.00	Rezervuar	-
78.00	Plumbi dhe artikujt prej tij	10
79.00	Zinku dhe artikujt prej tij	10
80.00	Kallai dhe artikujt prej tij	10
81.00	Metale të tjera bazë, metalo qeramike, artikujt prej tyre	10
82.00	Veglat e punës, pajisjet, takëmet e ngrënies lugë dhe pirunj, pjesët e tyre prej metali	20
83.00	Artikuj të ndryshëm me metale bazë	20
84.01	Makineritë bujqësore	0
84.02	Ngrohësit e ujit, pajisjet mekanike, makineritë mekanike dhe pajisjet e tyre	20
85.00	Pajisjet dhe makineritë elektrike dhe pjesët e tyre, aparatet e regjistrimit apo riprodhimit të tingullit, aparatet e regjistrimit apo të riprodhimit në TV	20
86.00	Lokomotivat, vagonat e pjesët e tyre, sinjalet dhe pajisjet e kontrollit mekanik	10
87.01	Traktorët	0
87.02	Mjetet e transportit, veç vagonave të hekurudhave dhe tramvajeve si dhe veç traktorëve. Pjesët dhe plotësuesit e tyre	10
88.00	Avionët, anijet kozmike dhe pjesët e tyre	5
89.00	Anijet, varkat dhe strukturat e flotës detare	10
90.00	Instrumentet dhe aparaturat optike, fotografike, kinematografike, matëse, kontrolli, precize mjekësore si dhe pjesët e tyre	10
91.00	Orët dhe pjesët e tyre	40
92.00	Instrumentet muzikore dhe pjesët e tyre	30
93.00	Armët, municionet dhe pjesët e tyre	30
94.01	Mobiljet, pajisjet e fjetjes dyshekët. Llampat dhe pajisjet e dritës së papërmendura diku tjetër, shenjat ndriçuese etj.	30
94.02	Parafabrikate	10
95.00	Lodrat, pajisjet e sportit dhe të lojrave të ndryshme	30
96.00	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	40
97.00	Veprat e artit, pjesët e mbledhura nga koleksionistët dhe antikat	0

Shënim:

Disa nga taksat fikse për automjetet e përdorura, Kreu 87.02 ndryshojnë si më poshtë:

- autoveturat mbi 10.000 km	22.5 mijë lekë
- motoçikletat e triçiklet e të gjitha llojeve mbi 5 mijë km	3 mijë lekë

Lista nr.3

LISTA E MALLRAVE PËR TË CILAT ZBATOHEN TAKSAT DOGANORE NË EKSPORT DHE
TARIFAT PËRKATËSE

Përshkrimi i mallit	Tarifat doganore në %
1. Peshk i freskët, i tharë, i kripur, i tymosur dhe i ngrirë i të gjitha llojeve si dhe molusqet e krustacet e të gjitha llojeve	deri në 50
2. Bimë mjekësore të çdo lloji	deri në 40
3. Kafshë të gjalla për prodhim mishi të ngrënshtëm	deri në 50
4. Lëkurë të papërpunuara	deri në 40
5. Duhan i papërpunuar	deri në 40
6. Lëndë drusore e papërpunuar	deri në 70